

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësin Veton Gota, praktikant i kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te pandehurit A. I., nga fsh. P. i E.- K.R. ,i akuzuar sipas aktakuzës se PSH ne Prizren PP/II.nr.727-7/16 te dt.21.07.2016, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 te KP, në prezencën e të akuzuarit, prokurorit te shtetit Zejnullah Gashi, më dt.10.10.2017, murr dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri :**

A. I. , i lindur me *data e lindjes...* ne fsh.P. i E.-R. ku edhe jeton, nga i ati H., dhe e ëma R., e lindur G., ka te kryer shkollën fillore, i martuar, baba i 6 fëmijëve, punëtor, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar - shtetas i R te Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Me datë 27.03.2016 rreth orës 18:50 minuta, në rrugën ... në Prizren, duke lëvizur me automjetet të markës FIAT SCUDO ngjyrë e bardhë me tabela të regjistrimit *numri i targës...*, i cili është ndaluar nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, ku gjate kontrollit te dokumenteve nga zyrtari policor, konstatohet se me dashje ka përdorur (prezantuar) dokumentin e falsifikuar si të vërtete ne atë mënyre qe ne automjetin e përmendur ka vendosur targën e regjistrimit te automjetit tjetër.

Kësodore ka kryer veprën penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.1 te KP-se.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 3, 4, 41, 43, 46 të KP i shqipton:

**DENIM ME GJOBË**

Ne shume prej 140 (njëqindekatërdhjetë) euro, të cilin dënim do ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi , e po qese dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin e sipërpërmendur, i njëjti do te zëvendësohet me dënim burgu duke llogarite 20 euro , një dite burg qe do te thotë 7 dite burg.

Te akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues konfiskohen tabelat e regjistrimit *numri i targës...*

Obligohet I pandehuri qe ti paguajnë te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, kurse ne emër te paushallit gjyqësor te paguajnë shumen prej 20 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Prizren , i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP/II.nr.727-7/16 te dt.21.07.2016, kundër te pandehurit A. I. për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 te KP,

Gjykata për këtë çështje penale ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestarë, në të cilin shqyrtim është lexuar aktakuza nga prokurori i çështjes

Pasi qe i akuzuari A. I. e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën ngarkohet sipas kësaj aktakuzë të njëjtën e ka pranuar në tërësi.

Gjyqtari gjykues konstaton se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 te KPP-së pas vlerësimit te të njëjtave gjegjësisht u vërtetua se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajit, pranimi është i vullnetshëm, dhe mbështetet ne faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.2/1-31 të KP, prandaj dhe ia shqiptoi dënimin me gjobë, duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimi do te arrihet qëllimi i të njëjtit.

Me rastin e vërtetimit te dënimit për veprën penale, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ne kuptim te nenit 73 të KP ndikojnë në përcaktimin e lartësisë se dënimit.

Gjykata çmoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese secilën në veçanti dhe lidhshmëri në mes të tyre në të gjitha rrethanat tjera të cilat ishin në ndikim në përcaktimin dhe qëllimin e dënimit. Si rrethanë rënduese gjykata kishte parasysh intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit te vlerës së mbrojtur, kurse në rrethanat lehtësuese pranimin e fajit nga ana e te akuzuarit si dhe rrethanat e tij familjare kur te kihet parasysh fakti se i njëjti është i gjendjes se varfër ekonomike, i pa pune.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është mare ne kuptim te nenit 450 dhe 452 të te KPP-se.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1573/16 të dt 10.10.2017**

**Procesmbajtësi:**  
**Veton Gota**

**Gjyqtari:**  
**Refki Piraj**

**UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit ne Prishtine , e nëpërmjet të kësaj gjykate.**